



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112102-17478
Datë: 01.09.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 39 paragrafi 5 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 59 të Rregullores numër 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe kërkesën e NJMBNJ drejtuar DMZP të datës 25.08.2023 për propozimin e një anëtari të komisionit që është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Vlerësimit për zhvillimin e procedurës RN00012405 të ngritjes (avancimit) në detyrë për pozitën **Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim**.
2. Komisionin e Vlerësimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Kushtrim Brahimaj – Kryesues (Menaxher i Burimeve Njerëzore)
 - 2.2. Teuta Krasniqi – Anëtare (Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore)
 - 2.3. Dervish Tahiri – Anëtarë (Drejtor i Qendrës për Punë Sociale)
3. Komisioni i Vlerësimit fillon punën gjatë fazës së përgatitjes për testimin dhe intervistimin e kandidatëve të paraqitur, dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit.


A r s y e t i m

Komisioni është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, mbajtjen e testeve të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshëm.

Me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë vend të punës, u caktua komisioni si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës